



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:302538

Datë: 02.12.2024

Numri i dokumentit: 06533015

**C.nr.1034/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, me gjyqtarin individual Avdirrahman Gashi, me bashkëpunëtoren profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M. O. nga fsh. G. e U., të cilën e përfaqëson Qendrim Reçica av. nga Lipjani, me autorizim kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Lipjan, për shkak të kompensim në bazë të shujtës ditore dhe kualifikim, jashtë seance gjyqësore, me dt.27.11.2024 merr këtë:

**A K T G J Y K I M  
PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES**

**APROVOHET** në tërsi si e bazuar kërkesëpadia e precizuar e paditëses M. O. nga fsh. G. e U., dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Lipjanit– Drejtoria e Arsimit, që paditësit t’ia paguaj në emër të shpenzimeve të ushqimit për periudhën nga dt.21.01.2021-21.11.2022 për 360 ditë pune në shumën prej **720.00-€**, dhe në emër të kualifikimit për periudhën 21.01.2021-06.02.2023 për 27% të pagës bazë në shumë prej **1,383.75-€**, të gjitha këto shuma me kamatë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë dt.28.12.2023 e deri në përmbushjen definitive si dhe t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 238.00-€ në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësja Mirdita Olluri nga fsh. Gadime e Ulet përmes të autorizuarit të kjo gjykatë ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Lipjanit – Drejtoria e Arsimit, për kompensim në emër të shpenzimeve të udhëtimit dhe kualifikimit. Në padi i autorizuarit i paditëses ka theksuar se paditësja është e punësuar te e paditura në SHFMU ”Z. H.” në fsh. G. e E. dhe e njëjta i plotëson kushtet e përfitimit shtesës në pagë në emër të shpenzimeve të ushqimit dhe shtesën në pagë në emër të kualifikimit.

I autorizuarit i paditëses përmes parashtrësës së datës 15.11.2024 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë më konkretisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në të përgjigjur në padi e paditura e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë dhe ka shtuar se sipas nenit 90 pika 5 të Ligjit 03/L212 të Punës në të cilën thirret paditësja, thuhet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshje të tilla kolektive e që në rastin konkret e paditura Komuna e Lipjanit si punëdhënëse e paditëses nuk është nënshkruese e kësaj Marrëveshje-

Kontratës Kolektive në të cilën është thirrur pala paditëse. Poashtu nëse merret parasysh Kontrata Kolektive në nenin 46 par.2 shprehimisht thotë se pagesa e tillë si për kompensimin e ushqimit dhe të udhëtimit bëhet brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, e që konsideron se nuk janë plotësuar këto kushte, sepse të paditues nuk i janë ndarë mjete financiare nga institucionet nënshkruese të Kontratës Kolektive. Ndërsa sa i përket kualifikimit ka shtuar se vendimi i QRK-së nr.03/33 nuk parasheh asnjë obligim për Komuna. I ka propozuar gjykatës që konform dispozitave ligjore të LK-së nenit 399 par.1 dhe 2 padinë e paditësit ta refuzon si të pabazuar-e pathemeltë.

Gjykata pasi vlerësoj padinë e paditëses dhe poashtu pasi vlerësoj përgjigjen në padi konstatoi nga provat e bashkangjitura në padi (nga kontrata e punes për paditësin 04-112/813/2658 të dt.02.09.2019, vërtetimi nr.08/4490 dt.20.12.2023 i lëshuar nga SHFMU “Z. H.”, lista e pagave për paditësen dhe Diploma universitare e dt.29.06.2013 e lëshuar nga Universiteti ... Prishtinë) se e paditura për kundër kontestimit të bazës juridike të padisë i ka pohuar faktet vendimtare në këtë çështje kontestimore, pra faktet se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, mësimdhënëse në SHFMU “Z. H.” në fsh. G. e E., ka punuar si mësimdhënës dhe për periudhën kontestuse e njëjta ka gjithësej 360 ditë pune dhe për këtë periudhë kontestuse ka punuar me Diplomë universitare ku i takon kompenzimi shtesë në pagën bazë prej 27 %, me arsyetimin se nga e paditura se KKA e vitit 2021 nuk është detyruse për të paditurën, si dhe shtesën në emër të kualifikimit me arsyetimin se vendimi i Qeverisë për shtesat në kualifikim nuk paraqet ndonjë detyrim për të paditurën andaj gjykata konform nenit 152 të LPK-së e aprovoi kërkesëpadinë e precizuar të paditëses pasi që nuk ka pengesa tjera ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje kontestimore nuk ka qenë e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor sepse, themelësia e kërkesëpadisë është vërtetuar në provat që u përmenden më lart dhe në bazë të nenit Me dispozitën e nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr.105 të dt. 22.01.2021, parashihet se punëtorët anëtar të SBASHK-ut punonjësit arsimor kompensohen për shpenzimet e ushqimit me nga 2 euro për një ditë pune. Ndërsa me Vendimin e Qeverisë 01/33 dt.29.03.2008 është paraparë rritja në emër të kualifikimit prej 27% të pagës bazë për të diplomuarit me Diplomë universitare.

Poashtu me nenin 8 të LMD-së, ku thuhet se “*Pjesëmarrësi në marrëdhënie të detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit*”, e të cilin detyrim e paditura nuk e ka përmbushur ndaj paditëses.

Pra, mbi gjendjen faktike që u përmend më lart dhe dispozitat materiale të lartë përmendura paditëses i takon shtesa në pagë në emër të shujtës ditore për ditët e pranisë në punë dhe kompensimi shtesë në emër të kualifikimit pasi paditësja ka punuar si mësimdhënëse me Diplomë universitare për periudhën 21.01.2021-06.022023, dhe se e paditura ka për detyrë t’ia kompensoj këto shtesa sepse është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimit andaj gjykata e detyroj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shtesat për ushqim, udhëtim dhe për kualifikim.

Gjykata me rastin e vendosjes vlerësoj kundërshtimet e të paditurës mirëpo të njëjtat kundërshtime i refuzoj si të pa bazuara me arsyetimin se KKA e vitit 2021 që është zbatueshme në rastin konkret është e detyrueshme për të paditurën dhe në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate përcaktohet se “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”. Gjithashtu gjykata vlerësoj edhe kundërshtimin tjetër të paraqitur se vendimi i

Qeverisë nuk është detyruar për të paditurën mirëpo gjykata edhe këtë kundërshtim e refuzoj si të pa bazuar sepse e paditura ka pasur obligim që tja paguaj shtesën në pagën bazë prej 27% dhe se pjesërisht e ka përmbushur këtë pjesë por pjesën tjetër nuk e ka përmbushur, ndaj vendimi i Qeverisë është akt nënligjor i cili paraqet akt të detyrueshëm për zbatim nga e paditura.

Vendimi për kamatën u bazua në nenin 382 par.2 të LMD-së, ku është llogaritur kamata prej 8% nga data e ushtrimit të padisë e deri tek pagesa definitive nga arsyet se kemi të bëjmë me dëm material e që duhet të llogaritur nga paraqitja e kërkesës kjo edhe në pajtim me mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Meqenëse pala paditëse e ka fituar kontestin dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës gjykata konform nenit 452 dhe 453 të LPK-së e detyroj të paditurën që palës paditësi tja kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë shumën prej 104 euro për përpilimin e padisë, për parashtresë për precizimin e kërkespadiisë shumë prej 104-€, të llogaritura me vlerë të kontestit të vogël deri në 10,000.00 euro si dhe shumë prej 30.00 euro në emër të taksës gjyqësore, apo shumë e përgjithshme prej 238-€, shpenzime këto që kanë qenë të nevojshme për përfundimin e këtij kontesti për qka edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lart dhe dispozitave të lartpërmendura u vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE-DEGA NE LIPJAN**  
**C.nr.1034/2023 me datën 27.11.2024**

**Gj y q t a r i**  
**Avdirrahman Gashi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2023:302538  
Datë: 02.12.2024  
Numri i dokumentit: 06533015